

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Edhe një i vdekur nga virusi i Nilit Perëndimor në Kosovë, shtatë të infektuar
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/dy-te-vdekur-nga-nili-perendimor-ne-kosove-shtate-te-infektuar
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 02:18:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:56:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e2de8079625d41b79e1e6c257880e30634d4e7ed6c16cb0f5d29ee981289b59
TEKSTI	018cb9c912427a620a4de2f55204746922a1f79f07e8b36df89bf053328a068c
PAMJA	be59de4460df233d3162041c1c2ad6f5ad3055e9af0a42e6d61854e9c5993069

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7eba4cec4eaa424a011c3d4cb99e968756374cc4775b0093142148313206fbf9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4de269ffc6a297af7c396c32fb13741f5fd12f8a3433567c0e499af34b76d0f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7eba4cec4eaa424a011c3d4cb99e968756374cc4775b0093142148313206fbf9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Edhe një i vdekur nga virusi i Nilit Perëndimor në Kosovë, shtatë të infektuar



19 shtator 2026 14:56

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Edhe një i vdekur është regjistruar në Kosovë nga virusi i Nilit Perëndimor. Ndërsa janë konfirmuar shtatë raste të infeksionit me virus, njoftoi Instituti Kombëtar i Shëndetësisë. Disa ditë më herët, IKSHPK-ja njoftoi për vdekjen e parë nga ky virus në Kosovë.

Të gjitha rastet janë hospitalizuar në Klinikën Infektive të QKUK-së në Prishtinë: tri me shenja klinike të meningjtit akut, tri me shenja të meningoenfalitit akut dhe një rast me gjendje febrile.

"Gjatë periudhës 7 gusht–18 shtator 2026, në Laboratorin e Mikrobiologjisë të IKSHPK-së janë konfirmuar shtatë raste të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) në Kosovë. Prej tyre, pesë janë meshkuj dhe dy femra. Dy raste i përkasin grupmoshës 10–19 vjeç, ndërsa rastet e tjera janë të moshave deri në 79 vjeç. Tri raste janë nga Gjakova, ndërsa nga një rast është regjistruar në Prishtinë, Shtime, Ferizaj dhe Pejë", thuhet në njoftimin e Institutit.

Sipas IKSHPK-së, nga analiza fillestare nuk është evidentuar lidhje epidemiologjike ndërmjet rasteve, prandaj ato janë klasifikuar si sporadike. Ndërkaq, vetëm një nga shtatë rastet ka raportuar histori udhëtimi jashtë vendit.

Në laboratorët e IKSHPK-së po analizohen edhe mostra të tjera të dyshimta, ndërsa vazhdojnë aktivitetet për monitorimin dhe kontrollin e situatës epidemiologjike.

IKSHPK-ja u ka bërë thirrje të gjitha komunave, në veçanti atyre ku janë konfirmuar raste, që të intensifikojnë dezinfektimin kundër mushkonjave dhe eliminimin e vatrave të shumimit të tyre. Masat duhet të përfshijnë spërkatjen në zonat me prani të shtuar të mushkonjave, largimin e mbeturinave dhe sanimin e kanalizimeve të hapura.

Për mbrojtje personale IKSHPK rekomandon përdorimin e repelentëve kundër mushkonjave, veshja e rrobave me ngjyra të çelëta që mbulojnë pjesën më të madhe të trupit, vendosja e rrjetave mbrojtëse në dritare dhe përdorimi i pajisjeve mbrojtëse në ambient të jashtëm.

Showbiz.

"Animals" e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

Futboll.

Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Venezian

Futboll.

Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevilas

Shtojca për Kulturë.

Kur pikëllimi shndërrohet në krenari

Arbëri.

Kurti: Nevojitet strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit të Speciales

Basketboll.

Bora e nis edicionin e ri me fitore të thellë

Edhe



Arbëri • 7 gus 2026

Konfirmohet një rast pozitiv me virusin e Nilit Perëndimor

Udhëtarët që vizitojnë zona ku raportohen infeksione të transmetuara nga mushkonjat, pas kthimit, rekomandohet të përcillet gjendja shëndetësore për paraqitjen e temperaturës, dhimbjes së kokës, lodhjes, skuqjes së lëkurës ose shenjave neurologjike.

"Në rast të shfaqjes së simptomave duhet të kërkohet vlerësim mjekësor pa vonesë dhe profesionisti shëndetësor të informohet për historinë e udhëtimit dhe ekspozimin e mundshëm ndaj mushkonjave", apelon Instituti.

#VIRUSI I NILIT

#KOSOVA

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 18 sht 2026

Thirrje për kujdes e dezinfektim pas regjistrimit të vdekjes së parë nga virusi "Nili Perëndimor"



Arbëri • 17 sht 2026

Regjistrohet vdekja e parë në Kosovë nga virusi i Nilit Perëndimor



Rajon • 18 gus 2026

Katër të vdekur dhe 35 raste të virusit të Nilit Perëndimor në Maqedoninë e Veriut



Arbëri • 27 gus 2026

50 raste me Ethet e Nilit në Maqedoni të Veriut

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbejnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.